



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2021:009754

Datë: 13.01.2023

Numri i dokumentit: 03854729

A.nr.134/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, F.S nga fshati..., komuna e M..., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Pensioneve, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 28.12..2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, F.S nga fshati ..., komuna e .....

II. Anullohet aktvendimi me numër të dosjes 5096734 i datës 09.12.2020, i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, në prani të paditëses dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore.

Paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, kërkoi nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia ime si e bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës datës 09.12.2020, si i pabazuar në ligj. Konsideroi se e paditura ma ka bërë të pa drejtë me rastin e refuzimit të pensionit me aftësi të kufizuar, pasi që këtë të drejtë e kam realizuar për dy vite radhazi, mirëpo kjo e drejtë më është ndërprerë në vitin 2020. Andaj konsideroi që kjo e drejtë të më takon mua. Në fund thekson se, kërkoj nga gjykata të anulohet vendimi kontestues i të paditurës dhe çështja të shkon në rivendosje tek e paditura në mënyrë që komisioni edhe njëherë të konstaton gjendjen time shëndetësore.

E paditura në përgjigjen në padi të parashtruar me datë 17.10.2020, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nga Komisioni ekspert mjekësorë nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore, kanë vlerësuar dokumentacionin në tërësi, ku për baze kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësorë si dhe raportet nga specialistet, ku është konstatuar se paditësi nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuar të plote dhe të përhershme siç përcaktohet sipas dispozitave ligjore për personat me aftësi të kufizuar ashtu që i propozon gjykatës që të refuzon kërkesë padinë e paditësit në tërësi si të pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurës si i bazuar në ligj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 28.12.2020, ka administruar provat relevante: vendimi i dt.09.12.20; vendimi i dt.24.08.20; raporti nga konsulta i dt.07.05.19; raporti nga konsulta i dt.22.09.20; udhëzimi për konsultim i dt.21.01.20; raporti nga konsulta i dt.14.07.20; udhëzimi për konsultim dt.13.07.2; udhëzimi për konsultim i dt.13.07.20; raporti nga konsulta i dt.14.07.20; vendimi i dt.25.11.11994 me nr.Pbr 662/92; vendimi i dt.22.04.1996 me nr.Gzh VR 418/95; vendimi i dt.13.06.1996; vendimi i dt.23.07.1996; raporti përfundimtar i mjekut i dt.25.08.1987; vendimi i dt.16.09.19; vendimi i dt.14.08.18; raporti specialistik i dt.14.05.19; raporti nga konsulta dt.20.04.18; raporti nga konsulta dt.10.07.19; raporti nga konsulta dt.07.05.19 dhe i dt.13.10.17, 20.04.18; kërkesa e dt.24.04.18; vlerësimi i komisionit mjekësor të dt.10.08.19; rivlerësimi dt.18.06.19; shqyrtimi i ankesave dt.19.11.20; certifikata e mjekut dt.18.10.17; raporti nga konsulta dt.13.10.17 dhe raporti nga konsulta 20.04.18.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet administrative, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta, për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84, paragrafi 2, të këtij ligji, është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimi i goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetua, respektivisht në nenin 85, të këtij ligji, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara,

ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit, ndërsa, nëse është i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës, apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Këshilli i Ankesave si organ i shkallës së dytë me ekspert mjekësorë të lëmisë përkatëse duke vepruar sipas ankesës të z/znj F.S., ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës në seancën e datës 10.02.2020, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit të shkallës së parë, në përputhje e paragrafin 5 të nenit 9 për PAK, dhe ka konstatuar – vlerësuar se nuk ka dokumentacion mjekësorë të mjaftueshëm për të qene përfitues i pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, prandaj Komisioni mjekësorë i shkallës së dytë pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësorë të shkallës së parë që nuk janë plotësuar kriteret e parapara me ligj.

Gjykata nga shkresat e lëndës ka vërejtur se, nga vendimi i të datës 16.09.2019, i është aprovuar e drejta në pensionin e personave me aftësi të kufizuar për 2 (dy) vite.

Ndërsa, me vendimin e organit të shkallës së parë të paditurës të datës 14.08.2020, gjykata vëren se paditësit i është ndërprerë e drejta në pensionin e personave me pa aftësi të përhershme me konstatim se, pas rishqyrtimit dhe rivlerësimit të të gjitha shkresave në lëndë dhe në bazë të rivlerësimit të komisionit mjekësorë të datës 19.11.2020, u vërtetua se gjendja shëndetësore në krahasim me gjendjen e mëparshme është përmirësuar, prandaj komisioni mjekësorë konstaton se nuk janë përmbushur kriteret për vazhdimin e të drejtës në pension të personave me pa aftësi të përhershme në harmoni me nenin 1,2 dhe 9 të ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i shkallës së dytë, këtu i padituri më vendimin e datës 09.12.2020, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë nuk ka dokumentacion të mjaftueshëm për të qenë përfituese e pensionit për persona me pa aftësi të përhershme, kur me vendimin e datës 14.08.2020, i është ndërprerë e drejta në pension, kurse nga vlerësimet e Komisionit mjekësorë nuk shihet se si ka ardhur deri në këtë përfundim, pasi që paditësja këtë të drejtë e ka shfrytëzuar për dy vite radhazi, ku për këtë periudhë kohore, e njëjti ka plotësuar kushtet për të qenë përfituese e Pensionit për Personat me Aftësi të Kufizuar të Plotë dhe të Përhershme.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në ri procedurë të veprjë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë, të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**  
**A.nr.134/2021 data: 28.12.2022**

Gjyqtare  
Luljeta Maxhuni

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.